

AKT – THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
“ A.S.I. ”SHPK

Në bazë të ligjit 7638 datë 19/01/1992 “Për Shoqëritë Tregëtare” krijohet në Fier sot më 03/03/2005 nga shtetasit:

Astrit Gjikonaj i biri i Jakupit dhe i Qafiles, i datëlindjes 1969, lindur në Vlore dhe banues në komunën Levan, Fier,

Andrea Gjikonaj i biri i Jakupit dhe i Qafiles, i datëlindjes 1969, lindur në Vlore dhe banues në komunën Levan, Fier,

madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar shoqëria “A.S.I.” me Përgjegjësi të kufizuar.

HYRJE

Neni 1

Në kuptim të këtij ligji akti themelimi është krijimi i Shoqërisë “ A.S.I. ” me përgjegjësi të kufizuar nga ortakët, Astrit Gjikonaj dhe Andrea Gjikonaj.

Neni 2

EMRI I PLOTE I SHOQERISE

Emri i plotë i shoqërisë është : “A.S.I”, që këtu e më poshtë dhe gjithmonë në të ardhmen ai do të shoqërohet nga prapashtesa Sh.p.k.

O B J E K T I

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

1. Në fushën e ndërtimit:

Në zbatim

- | | |
|---------------|--|
| Kat. 1 | Gërmime dheu me punime eventuale murature e beton arme-prishje dhe punime në tokë të gërmuar. |
| Kat. 2 | a. Prodhim materiale inerte – gurë
c. Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshme-parnderur-gurë dekorativ |
| Kat. 3 | a. Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore, deri në 5 kate. |
| Kat. 4 | a. Ndërtim rruge kategoria IV dhe V
c. Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim |

- mbishtresa rrugore.
- Kat. 6 a. Ndërtim ura dhe vepra arti deri 10m
- Kat. 8 a. Ndërtim ujësjellës – kanalizime – kanale e impiante vaditje.
- Në Projektim**
- Kat. 3 a. Objekte civile – Industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- Kat. 6 a. Rrugë auto kategoria V dhe IV..
- Kat. 7 a. Projektim ura dhe vepra arti deri 10m

2. Në fushën e shërbimit

- a) Punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe – pyll parqe.
- b) Pastrim i sipërfaqeve urbane.
- c) Kryerja e punimeve në shërbesa funerare

3. Në fushën e tregtis do të importoj dhe eksportoj duke tregtuar me shumicë dhe pakic :

- a) Artikuj të ndryshëm industrial dhe ushqimore.
- b) Artikuj të ndryshëm bujqësor dhe blektoral.
- c) Tregtim me pakic të karburanteve dhe lubrifikantëve

4. Në fushën e transportit:

- a) Transport për vete dhe të tretë, jashte dhe brenda vendit.

SELIA E SHOQERISE

Neni 4

Selia e shoqërisë është në adresën : Lagja " Vresht", pallati 76, komuna Levan, Fier.

AFATI I VEPRIMTARISË

Neni 5

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar " **A.S.I.** " do të ushtrojë veprimtarinë e saj në një periudhë mbi **10 vjet** nga koha e regjistrimit si person juridik.

Neni 6

Aktet e Themelimit të shoqërisë janë efektive nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Neni 7

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin , selinë, objektin e veprimtarisë dhe gjithçka tjetër sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Ortakëve.



KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 8

Kapitali bazë i themelimit të Shoqërisë "A.S.I." Shpk është 125 000 lekë, i përbërë nga 125 pjesë me vlerë nominale 1000 lekë, e cila është investuar e gjithë nga ortakët në mënyrë të barabartë nga 62 500 lekë secili, ose çdo ortak zotëron 50% pjesë të barabartë të kapitalit dhe vërtetohet nga mandati arkëtimi i derdhur pranë Tirana Bank, Dega Fier i cili i bashkangjitet këtij akti.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori.

Asambleja e Ortakëve për bëhet nga ortakët: Astrit Gjikonaj dhe Andrea Gjikonaj.

Administrator i shoqërisë "A.S.I." Shpk është ortaku Andrea Gjikonaj.

Neni 10

Asambleja e Ortakëve emëron të gjithë personelin administrativ e operativ, ekspertin Kontabël të Autorizuar, si dhe i shkarkon ata kur ajo e shikon të arsyeshme.

Neni 11

Eksperti kontabël, personeli administrativ i emëruar nga Asambleja e ortakëve duhet të ruajnë karakterin sekret të dokumentacionit, si dhe fitimin e realizuar.


DETYRIMET

Neni 12

Ortakët marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga sipërmarrja e emëruar "A.S.I." Shpk. Në mbështetje të dispozitave të më sipërme, aktiviteti i Shoqërisë zhvillohet në bazë të parimeve të ekonomisë së tregut në përputhje me të gjitha rregullat dhe ligjet në fuqi.

Neni 13

Shoqëria duhet të shlyejë rregullisht brenda afateve detyrimet ndaj shtetit dhe të tretëve sipas dispozitave në fuqi.



BILANCI DHE PASQYRA HUMBJE - FITIM

Neni 14

Veprimtaria e Shoqërisë mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti. Kontabilisti i Miratuar ose persona të tjerë të autorizuar nga Asambleja e Ortakëve, janë të detyruar që në përputhje me ligjin 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligji 7636 datë 19.01.1993 "Për Kontabilitetin" të nxjerrin bilancin periodik vjetor".

Neni 15

Mbyllja e bilancit vjetor shoqërohet me analizën e pasqyrës humbje fitim, pasqyrën e lëvizjes së kapitalit, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, që i përkasin ushtrimit e që deklarohen në organet fiskale dhe që kanë karakter të publikushëm për shoqërinë.

Neni 15

Pas mbylljes së bilancit vjetor, shoqëria detyrohet të miratojë bilacin brenda 6 mujorit të parë në bazë të Ligjit Nr 9326 datë 6.12.2004 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, neni 33, pika 4 dhe të deklarojë brenda datës 31 korrik në Organet Tatimore shpërndarjen e fitimit sipas ligjit 7638 datë 19/01/1992 "Për Shoqëritë Tregëtare" i cili bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

JURIDIKSIONI

Neni 17

Shoqëria "A.S.I." Shpk rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me statutin, dispozitat e më sipërme dhe rregulloren e lejes që do t'i bashkangjitet akteve të themelimit të shoqërisë.

Neni 18


Mosmarrëveshjet me organet shtetërore, personat juridik e fizik zgjidhen nga "Qendra Shqiptare e Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregëtar" ose Gjykata e shkallës së parë Fier përcaktuar në ligjin 8116 datë 29.03.1996 "Kodi i Proçedurës Civile".

Neni 19


Në rast të prishjes së Shoqërisë Asambleja e ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit të saj dhe emëron një ose më shumë likujdues sipas dispozitave përkatëse të ligjit.

THEMELUESIT

Astrit Gjikonday,

Astrit Gjikonday


Andrea Gjikonday

Andrea Gjikonday




**STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“ A.S.I. ” Shpk

KREU I

Neni 1

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ A.S.I. ” Shpk krijohet në bazë të aktit të themelimit, datë 03/03/2005 nga ortakët Astrit Gjikonaj, Andrea Gjikonaj dhe ushtron aktivitetin si person juridik i pavarur.

Neni 2

Shoqëria e ushtron aktivitetin në bazë të ligjit 7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregëtare” dhe i nënshtrohet gjithë detyrimeve ligjore që lindin nga kjo veprimtari si dhe parimeve të ekonomisë së tregut.

Neni 3

Ortakët në këtë sipërmarrje fitojnë të drejta dhe marrin përsipër detyrimet sipas dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ekonomike e juridike të shoqërisë.

Neni 4

Shoqëria “A.S.I.” Shpk fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe pajisjen me lejen e ushtrimit të aktivitetit tregëtar nga Dega Tatim Taksave Fier.

EMRI, JURIDIKSIONI

Neni 5

Emërtimi i shoqërisë është: Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ A.S.I. ” Shpk.

Neni.6

Selia e shoqërisë është në adresën : Lagja “ Vresht”, pallati 76, komuna Levan, Fier.
Shoqëria mund të hapë filiale te tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni.7

Shoqëria do të ketë *vulën* e saj në formë të rumbullaktë me emrin përkatës të përmendur në dispozitat më lartë



OBJEKTI

Neni 8

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

5. Në fushën e ndërtimit:

Në zbatim

- Kat. 5 Gërmime dheu me punime eventuale murature e beton arme-prishje dhe punime në tokë të gërmuar.
- Kat. 6 a. Prodhim materiale inerte – gurë
c. Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshme-parnderur-gurë dekorativ
- Kat. 7 a. Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore, deri në 5 kate.
- Kat. 8 a. Ndërtim rruge kategoria IV dhe V
c. Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbishtresa rrugore.
- Kat. 6 a. Ndërtim ura dhe vepra arti deri 10m
- Kat. 8 a. Ndërtim ujësjellës – kanalizime – kanale e impiante vaditje.

Në Projektim

- Kat. 3 a. Objekte civile – Industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- Kat. 6 a. Rrugë auto kategoria V dhe IV..
- Kat. 7 a. Projektim ura dhe vepra arti deri 10m

6. Në fushën e shërbimit

- a) Punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe – pyll parqe.
- b) Pastrim i spërfaqeve urbane.
- c) Kryerja e punimeve në shërbesa funerare

7. Në fushën e tregtis do të importoj dhe eksportoj duke tregtuar me shumicë dhe pakic :

- a) Artikuj të ndryshëm industrial dhe ushqimore
- b) Artikuj të ndryshëm bujqësor dhe blektoral.
- c) Tregtim me pakic të karburanteve dhe lubrifikantëve

8. Në fushën e transportit:

- a) Transport për vete dhe të tretë, jashte dhe brenda vendit.

AFATI I VEPRIMTARISË

Neni.9

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "A.S.I." do të *ushtrojë veprimtarinë e saj në një periudhë mbi 10 vjet* nga koha e regjistrimit si person juridik.

Neni 10

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar nga momenti i regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Neni 11

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, objektin e veprimtarisë dhe gjithçka tjetër vetëm sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Ortakëve.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 12


Kapitali bazë i themelimit të Shoqërisë "A.S.I." Shpk është 125 000 lekë, i përbërë nga 125 pjesë me vlerë nominale 1000 lekë, e cila është investuar e gjithë nga ortakët në mënyrë të barabartë nga 62 500 lekë secili, ose çdo ortak zotëron 50% pjesë të barabartë, të kapitalit dhe vërtetohet nga mandat arkëtimi i derdhur pranë Tirana Bank, Dega Fier i cili i bashkangjitet këtij akti.

Neni 13

Ortakët janë përgjegjës për të gjitha detyrimet në ushtrimin e aktivitetit të përcaktuara në dispozitat e këtij akti. Shoqëria përgjigjet për humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin themeltar.

Neni.14

Pjesë e kapitalit janë të transferueshme në rrugë trashëgimnie si dhe tek të tretë. Rritja e kuotave të kapitalit bëhet në përputhje me bilancin financiar të realizuar gjatë vitit ushtrimor dhe në përputhje me ligjin 7636 date 19/01/1993 "Për Kontabilitetin"



KREU II

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni.15

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori.

Asambleja e Ortakëve për bëhet nga ortakët: Astrit Gjikonaj dhe Andrea Gjikonaj. Ajo është organi më i lartë për drejtimin e Shoqërisë dhe për vendimarrje në emër të saj.

Administrator i vetëm i Shoqërisë " A.S.I. " është ortaku z. Andrea Gjikonaj

Neni.16

Konsultimet e ortakëve, Thirja e asamblës së ortakëve.

Asambleja e Ortakëve pas konsultimit qoftë dhe me shkrim, miraton me shkrim përmbajtjen e konsultimit. Një prej ortakëve që përfaqësojnë 50% të pjesëve të kapitalit themeltar i lind e drejta të kërkojë mbledhjen e asamblese. Çdo mbledhje e asamblës së thirrur në mënyrë të pa rregullt, mund të anulohet, anulimi nuk ka vlerë në rastë se të gjithë ortakët janë të pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni.17

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër të barabartë votash me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Një ortak mund të përfaqësohet nga një tjetër person i afert me prokur vetëm për atë mbledhje radhe dhe qëllimin për të cilin është thirrur asambleja

Neni.18

Asambleja e ortakëve ka në kompetencën e saj eskuzive këto të drejta:

- Të miratoj dhe të ndryshoj statusin e Shoqërisë, me vendim absolut
- Vendos për zmadhimin kapitalit me anën e kontributeve në natyrë ose zvogëlin e tij, sipas rastit.
- Të vendosi për shpërbërjen e shoqërisë kur ajo është në falimentim.
- Të miratoj raportin e administrimit të llogarive vjetore si dhe të shlyejnë detyrimet financiare ndaj shtetit dhe të tretëve.
- Të vendosi në shpërndarjen e fitimit dhe të mbulimit të humbjeve.
- Rregullon marrëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë
- Për një administrim më të mirë Asambleja e ortakëve mund të emërojë edhe një administrator tjetër.
- Emëron dhe shkarkon administratorin me vendim me vendim absolut të ortakëve.



Neni 19

Asambleja e ortakëve emëron personelin administrativ e operativ për të drejtuar sipërmarrjen me vendim absolut. Baza ligjore është lidhja e kontratës së punës midis punë marrësit dhe punë dhënësit.

Neni. 20

Asambleja e ortakëve emëron Ekspertin Kontabël të Autorizuar dhe Kontabilistin e Miratuar me vendim absolut dhe vetëm kur ata nuk përmbushin kërkesat ligjore, Asamblesë së ortakëve i lind e drejta të marrin një vendim tjetër për të emëruar një ekspert tjetër, ose grup ekspertesh.

Neni 21

Eksperti kontabël, Kontabilisti i Miratuar, personeli administrativ-operativ të emëruar nga Asambleja e ortakëve duhet të ruajnë karakterin sekret të dokumentacionit, si dhe fitimin e realizuar.

Neni 22

Asambleja e ortakëve shkarkon Ekspertin Kontabël të Autorizuar dhe Kontabilistin e Miratuar si dhe personelin administrativ operativ kur ai e shikon të arsyeshme me vendim absolut.

Neni. 23

Asambleja e ortakëve ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e sipërmarrjes dhe mban përgjegjësi ligjore për të gjithë aktivitetin. Në marrëveshjet me të tretët administratori angazhon shoqërinë në përputhje me objektin e saj dhe shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e administrimit.

Neni.24

Asambleja e ortakëve mund të emëroj edhe një administrator tjetër për të ndihmuar në drejtimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga aktet e administrimit të sipërmarrjes.

Neni.25

Zhvillimi i sipërmarrjes do të bëhet në bazë të rregullores së brendëshme të shoqërisë në bazë të të gjitha ligjeve në fuqi.

Neni 26

Për drejtimin e sipërmarrjes Asambleja e ortakëve duhet t'i bëjë të njohur personelit administrativ dhe atij operativ kushtet dhe rregulloren e brendëshme të punës të miratuara prej saj.

Neni. 27

Asambleja e ortakëve vendos për ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë " A.S.I. " Shpk, cakton detyra për personelin administrativ operativ si dhe përfaqëson Shoqërinë " A.S.I. " Shpk në marrëdhënie me organet shtetërore, bankat, të tretët, me të cilat ka lidhje kontraktuale. Në mungesë të tij administratori i emëruar më parë prej tij vepron me prokurë të posaçme për persona të tjerë.



Neni 28

Administratori ka për detyrë që gjatë zhvillimit të aktivitetit të plotësojë këto kushte:

- Të marrë të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhënie me të tretët në emer të shoqërisë, në të gjitha rrethanat, duke përjashtuar kompetencat që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.
- Të marrë përsipër shlyerjen rregullisht dhe brenda afateve, detyrimet ndaj shtetit dhe të tretëve
- Të pranojë të presë autoritetet e ndryshme të Pushtetit Lokal, te sistemit fiskal, etj.
- Të ketë një personel me kualifikim të përshtatshëm dhe përvojën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit.
- Të garantojë në çdo moment vijueshmërinë e sipërmarrjes.

KREU III

MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Neni 29

Asambleja e ortakëve vendos për personat që do të punësohen në shoqërinë "A.S.I." shpk. Punësimi do të bëhet në përputhje me ligjin 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punës"

Neni 30

Marrëdhëniet e punësimit rregullohen sipas kontratës së punës që lidhet midis palëve. Në këtë kontratë përcaktohen qartë kushtet e punës, të shpërblimit, të pushimit etj.

Neni 31

Administratori dhe personeli i shoqërisë duhet të ruajnë karakterin sekret të dokumentacionit si dhe fitimin e realizuar edhe pas ndarjes së tij.

Neni.32

Ndaj shkeljeve të mundëshme zbatohen masa ndëshkimore që merren nga Asambleja e ortakëve. Punonjësi që largohet nga puna duhet të bëjë dorëzimet e detyrës në bazë të një akti me shkrim pasi të ketë shlyer detyrimet materiale monetare n.q.s ka kundrejt sipërmarrjes.





MARRËDHËNIET FINANCIARE

Neni.33

Shoqëria përfaqësohet nga administratori z.Andrea Gjikonaj

Neni 34

Shoqëria ka të drejtë të ketë llogari likujduese në lekë ose në valutë të huaj pranë bankave të vendit ose të huaja në Shqipëri dhe të kryeje veprime nëpërmjet tyre.

Neni 35

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe respekton afatet e derdhjes së tyre. Personat e ngarkuar në këtë detyrë duhet të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar.

Neni 36

Veprimtaria e Shoqërise për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore fillon në date 1 janar të çdo viti dhe mbaron më date 31 dhjetor të çdo viti.

BILANCI DHE PASQYRA HUMBJE/FITIM

Neni.37

Bilanci pasqyron marrëdhëniet financiare ekonomike nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

Neni 38

Baza e bilancit është evidenca kontabël e hartuar nga financieri i punësuar nga shoqëria ose eksperti kontabël i Miratuar konform ligjit 7636 datë 19/01/1993 “ Për kontabilitetin”

Neni.39

Evidenca kontabël mbahet e detajuar për të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat.

Neni 40

Pagesa e personelit bëhet në përputhje me kontratën e punës e lidhur midis palëve

Neni.41

Fitimi neto i realizuar nga sipërmarrja është një fitim i tatueshëm

Neni 42

Veprimtaria e Shoqërisë mbyllet deri 31 mars të çdo viti pas ardhës. Kontabilisti i Miratuar ose persona të tjerë të autorizuar nga Asambleja e Ortakëve, janë të detyruar që në përputhje me ligjin 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligji 7636 datë 19.01.1993 "Për Kontabilitetin" të nxjerrin bilancin periodik vjetor të ushtrimit".

Neni 43

Mbyllja e bilancit vjetor shoqërohet me analizën e pasqyrës humbje fitim, pasqyrën e lëvizjes së kapitalit, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, që i përkasin ushtrimit e që deklarohen në organet fiskale dhe që kanë karakter të publikushëm për shoqërinë.

Neni 44

Pas mbylljes së bilancit vjetor, shoqëria detyrohet të miratojë bilacin brenda 6 mujorit të parë në bazë të Ligjit Nr 9326 datë 6.12.2004 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, neni 33, pika 4 dhe të deklarojë brenda datës 31 korrik në Organet Tatimore shpërndarjen e fitimit sipas ligjit 7638 datë 19/01/1992 "Për Shoqëritë Tregëtare" i cili bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 45

Me shpërndarjen e fitimit kuptohen veprimet e ortakëve pas mbylljes së bilancit vjetor me fitimin e realizuar vjetor dhe miratimit të tij në lidhje me fitimin e trashëguar siç janë rezervaligjore 5%, fondi i zhvillimit për strategji te reja, dividend i përfituar nga ortakët.

PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 46

Zvogëlimi i kapitalit themeltar nënvlerën e parashikuar në ligjë në krijimin e shoqërisë " A.S.I. "Shpk e detyrojnë këtë shoqëri të shndërohet në një shoqëri të një forme tjetër.

Neni.47

Asambleja e ortakëve ka të drejtën t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe të kërkoj prishjen e shoqërisë, në raste se dokumentat financiare rezultojnë me humbje.

Neni 48

Në raste të prishjes së Shoqërisë, Asambleja e ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit të saj dhe emëron një ose më shumë likujdues sipas dispozitave te ligjit. Në të kundërtën kjo çështje zgjidhet nga Gjykata Shkallës së Parë Tiranë.



Neni 49

Në rast se shoqëria vepron në kundërshtim me rregullat e caktuara në ligjin 7638 "Për shoqëritë Tregëtare" i hiqet leja e ushtrimit të profesionit nga organi që jep lejen kur konstaton shkelje të rënda të ligjit.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 50

Mosmarrëveshjet në marrëdhënie me organet shtetërore persona fizik juridik, vendas a të huaj, zgjidhen sipas dispozitave ligjore nga "Qëndrës Shqiptare të Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregëtar" dhe në rast të mos zgjidhjes prej saj, ortakut i lind e drejta t'i drejtohet Gjykatës së shkallës së parë Fier, përcaktuar në ligjin 8116 datë 29.03.1996 "Kodi i Proçedurës Civile".

Neni 51

Në rast të prishjes së Shoqërisë Asambleja e ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit të saj dhe emëron një ose më shumë likujdues sipas dispozitave përkatëse të ligjit.

Neni 52

Përsa është shprehur në këtë statut i referohet ligjit 7638 datë 19/11/1992 si dhe ligjit 7636 datë 19/01/1993 si dhe legjislacionit Fiskal në fuqi.


Neni.53

Statuti përpilohet në pesë kopje për t'u dorëzuar organeve kompetente të interesuara për të dhe firmoset nga antarët e Asamblesë së ortakëve në çdo faqe që e përbënë këtë akt.

U përpilua sot më datë 03/03/2005 në Fier.

ORTAKET

Astrit Gjilkondaj,



Andrea Gjilkondaj,

